

POLITIKA E JASHTME ITALIANE DHE PROGRAMI I ISMAIL QEMALIT PËR ARSIMIN NË SHQIPËRI

Dr. Erarba ÇIRAKU, Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike
Akademia e Shkencave të Shqipërisë
erarba_ciraku@yahoo.com;

Abstrakt

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, politika e jashtme e Italisë, në kuadër të interesave të saj gjeostrategjike në Ballkan, e pa Shqipërinë si aleate për të frenuar ndikimin grek dhe depërtimet sllave në brigjet e Adriatikut dhe Jonit. Në këtë kuadër, formimi i shtetit shqiptar dhe forcimi i vetëdijes kombëtare shqiptare përbënin objektivat strategjike të Italisë, ku arsimit dhe përhapja e gjuhës shqipe zinin një vend qendror. Dokumentet e arkivit diplomatik italian dëshmojnë për interesimin e Italisë në zhvillimin e arsimit dhe gjuhës shqipe, me vëmendje të veçantë ndaj programit të Ismail Qemalit për hapjen e shkollave shqipe dhe mbështetjen e alfabetit latin, që sipas tij do të shërbente për afrimin e shqiptarëve me Europën. Në rastin shqiptar, gjuha ishte shtylla më kohezive e identitetit kombëtar, çka e bënte edhe më vendimtare nevojën për një alfabet të unifikuar. Alfabeti nuk ishte vetëm një çështje gjuhësore, por edhe politike – një mjet për kapërcimin e ndarjeve krahinore dhe kulturore dhe për konsolidimin e kohezionit kombëtar në prag të formimit të shtetit shqiptar.

Fjalë çelës: gjuhë, komb, alfabet, arsim.

Italian Foreign Policy and Ismail Qemali's Program for education in Albania

Abstract

At the end of the 19th century and the beginning of the 20th, Italian foreign policy, driven by its geostrategic interests in the Balkans, identified Albania as a key ally in countering Greek influence and Slavic incursions along the Adriatic and Ionian coasts. In this context, the formation of an Albanian state and the strengthening of national consciousness became central to Italy's regional agenda, with education and the promotion of the Albanian language seen as essential tools. Archival evidence from the Italian diplomatic records reflects this commitment, especially through support for Ismail Qemali's program to open Albanian-language schools and adopt a Latin-based alphabet—an instrument he believed would reshape Albanian mentality and align it more closely with Europe. In the Albanian case, language was the most cohesive pillar of national identity, making the unification of the alphabet a foundational priority. The alphabet, therefore, represented not only a linguistic choice but also a political strategy aimed at overcoming internal regional and cultural divisions and building national unity on the path toward state formation.

Keywords: Albanian language, Albanian nation, alphabet, Albanian education.

Hyrje

Në procesin e formësimit të ndërgjegjes kombëtare, ndasia kulturore dhe religjioze që ka ekzistuar në shoqërinë shqiptare, përbën një aspekt që nuk duhet nënvlerësuar. Sigurisht, kjo ndasi duhet vlerësuar brenda kontekstit historik të periudhës. Nëse kombi është përcaktuar gjerësisht si një bashkësi shoqërore, ku ndahen të njëjtat zakone, religjion dhe gjuhë, në shoqërinë shqiptare të kohës, gjuha ishte ajo që mbante një unifikim më të fortë. Në një kontekst ku gjuha është një nga elementët kryesorë për të dalluar kombet, por jo gjithmonë ai më i rëndësishmi, ndihmën na e jep historiani Eric Hobsbawm, i cili thekson se, në disa raste, identifikimi kulturor mund të bazohet në gjuhë ose në një kompleks dialektesh, që kanë afërsi mes tyre.¹⁴⁰ Duhet pranuar se nacionalizmi shqiptar ka rrënjë popullore me karakter të mirëfilltë gjuhësor dhe proto-nacional. Arsyeja e kësaj veçorie qëndron kryesisht në rrethanat historike. Shqiptarët kanë jetuar për shekuj nën ndikime kulturore rivale, si ato helene, romake dhe sllave, duke përqafuar gjithashtu, ndaras, tre religjione që shpesh, ishin kundërshtarë me njëra-tjetrën. Të gjitha këto ndikime, përbënin arsye të forta që, ndryshe nga shumica e vendeve ballkanike, elita shqiptare të vendoste theksin tek gjuha dhe jo tek religjioni në procesin e formimit të identitetit dhe forcimit të unitetit kombëtar.¹⁴¹ Kjo ishte e domosdoshme, pasi feja dhe elementët e tjerë, shpesh i shërbenin më shumë ndarjes sesa bashkimit. Njësimi i alfabetit përbënte një parakusht të domosdoshëm në procesin e ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve. Prandaj, Kongresi i Manastirit, i mbajtur nën ndikimin e shpresave që u ngjallën nga xhonturqit kur morën pushtetin, pati si qëllim kryesor pikërisht njësimin e alfabetit shqip.

Në kuadër të interesave strategjike në Ballkan, ndërgjegjësimi kombëtar i shqiptarëve ishte gjithashtu i rëndësishëm për dy Fuqitë e mëdha të kohës, Italia dhe Austro-Hungaria. Për të dyja këto Fuqi, një komb dhe një shtet i fortë shqiptar, mund të shërbente si barrierë kundër përpjekjeve të shteteve sllave dhe greke për të zgjeruar ndikimin e tyre në brigjet e Adriatikut dhe Jonit.¹⁴²

Interesi i Italisë në çështjen e arsimit shqip, antagonizmi me Monarkinë Dualiste

Sipas Baldacci-t, djepi i filologjisë shqiptare, ashtu sikundër edhe vetë letërsia moderne shqipe, i ka rrënjët mes shqiptarëve të Italisë.¹⁴³ Ai kundërshton pikëpamjen e lingvistit francez Antoine Meillet, i cili cilësonte Austrinë si pararojën e ngjalljes së ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri përmes përhapjes së gjuhës shqipe.¹⁴⁴ Baldacci, ndër të tjera do të sjellë në vëmendje kundërpërgjigjen e Sotir Koleas, filologut të ri e tepër premtues së asaj kohe, ndaj të cilit ushqente vlerësim të veçantë. Kolea shprehej se mendimi i Meillet nuk ishte plotësisht i saktë, pasi ai e injoronte rolin e Italisë, e cila për shekuj kishte lejuar dhe përkrahur hapjen e shkollave dhe seminareve ku të rinjtë shqiptarë arsimoheshin në gjuhën e tyre. Pikërisht nga këto institucione, dolën një plejadë shkrimtarësh patriotë shqiptarë, të cilët, si qytetarë apo rezidentë të një vendi të lirë, kishin mundësinë të shkruanin dhe vepronin lirish për të nxitur patriotizmin në Shqipëri.¹⁴⁵

Austria, në kuadër të Protektoratit të Kultit, do të nisë mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e saj në Shqipëri. Me këtë hap, ajo synonte në radhë të parë ngjalljen e vetëdijes kombëtare tek shqiptarët,

¹⁴⁰ Hobsbawm, E. J. (1996). *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1970-a* (p. 59). Toena.

¹⁴¹ Çeku, E. (2024). *Shqiptarët dhe Shqipëria 1908-1912* (f.57-59). Universiteti i Prishtinës.

¹⁴² Ministero Degli Affari Esteri Commissione per La Pubblicazione dei Documenti Diplomatici. (1979). *Documenti diplomatici italiani* (Serie II, Vol. V). Istituto Poligrafico e Zecca Dello Stato Libreria dello Stato. Document no. 127; Berio to Visconti-Venosta, Shkodër, October 28, 1873; f. 134.

¹⁴³ Baldacci, A. (1929). *L'Albania* (f. 283). L'Istituto per l'Europa Orientale.

¹⁴⁴ Baldacci, A. (1929). *L'Albania* (f. 289). L'Istituto per l'Europa Orientale.

¹⁴⁵ Baldacci, A. (1929). *L'Albania* (f. 289). L'Istituto per l'Europa Orientale.

me qëllimin e formësimit të një Shqipërie të bashkuar, si përgjigje ndaj kërcënimeve të sllavëve¹⁴⁶; dhe, në pikë të dytë, t'i kundërpërgjigjej përhapjes së gjuhës dhe kulturës italiane.

Megjithëse hapat e politikës së jashtme italiane ndaj çështjes shqiptare kanë ardhur disi më vonë se ata të Austrisë, Italia është ajo që do të institucionalizojë për herë të parë albanologjinë, duke hapur katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Institutin e Gjuhëve Orientale të Napolit në vitin 1900. Austria do ta pasojë më vonë, në vitin 1903, me hapjen e katedrës së shqipes në Universitetin e Vjenës, nën drejtimin e Gjergj Pekmezit.

Megjithatë, deri në fund të shekullit të XVIII, dhe në kuadër të së drejtës për të mbrojtur kultin dhe Kishën Katolike në Perandorinë Osmane, të cilën Austria e kishte fituar me Traktatin e Vjenës në vitin 1616 dhe e kishte pasuar me një sërë traktatesh të tjera ndërkombëtare, austriakët kishin një avantazh të dukshëm në fushën e arsimit në Shqipëri. Ishin hapur seminari jezuit në Shkodër dhe dy lice, një i drejtuar nga jezuitët dhe tjetri nga françeskanët. Po ashtu, Austria kishte hapur shkolla edhe në qytete të tjera të rëndësishme, si Vlorë, Durrës, Prizren etj., dhe kishte financuar ndërtimin e një numri shkollash fillore.¹⁴⁷ Në kuadër të antagonizmit italo-austriak, Italia nuk mund të qëndronte pasive ndaj pranisë austriake në Shqipëri, prandaj ndërmori edhe ajo hapa të rëndësishëm. Faza e parë e këtij angazhimi u realizua përmes klerit katolik me origjinë italo-shqiptare dhe klerit katolik shqiptar, të formuar në seminarët ekleziastike italiane¹⁴⁸. Përgatitja e klerikëve të destinuar për Shqipërinë, jo rastësisht, bëhej në seminarët ekleziastike të Sant'Adriano-s dhe San Demetrio Corone-s. Këto rajone ishin të populluara nga arbëreshët, të cilët kishin ruajtur me besnikëri gjuhën dhe zakonet e të parëve.

Ardhja e Crispit në krye të qeverisë italiane, shënoi një periudhë të rëndësishme në politikën e jashtme italiane ndaj Shqipërisë. Gjatë vizitës së tij të parë pranë Bismarkut më 30 shtator 1887, ai deklaroi dy objektiva kryesore: i pari ishte ekspansioni në Lindjen e Afërme, dhe i dyti ishte afrimi gradual dhe paqësor i popujve ballkanikë drejt një ekzistence autonome.¹⁴⁹ Objektivat e politikës së Crispit diktoheshin nga bindjet e tij politiko-filozofike, si ihtar i Garibaldit dhe Mazzinit, por më e rëndësishmja, nga origjina e tij arbëreshe. Me miratimin e Crispit u inaugurua shkolla e parë laike, e cila mbështeste politikën ekonomike dhe kulturore italiane, të cilat synonin të tejkalonin ndarjen fetare mes shqiptarëve.¹⁵⁰ Këtu qëndronte edhe ndryshimi thelbësor mes shkollave austriake dhe atyre italiane. Shkollat austriake kishin një karakter thelbësisht religjioz, të drejtuara nga autoritetet klerikale, ndërsa shkollat italiane ishin shkolla shtetërore, të cilat drejtoheshin nga funksionarë laikë, nën juridiksionin e Inspektoratit të Përgjithshëm të Shkollave Jashtë Vendit, një organ i ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë.¹⁵¹

¹⁴⁶ Skëndi, S. (2000). *Zgjidhja kombëtare shqiptare 1878-1912* (f. 239-241). Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.

¹⁴⁷ Qesari, E. (2017). Le orme dell'egemonia italiana sul protonazionalismo albanese e lo scontro con l'alleato asburgico sull'istruzione scolastica. In F. Altamura (Ed.), *Puglia e Grande Guerra: Tra dimensione adriatica e fronte interno: Fonti e ricerche* (pp. 17-31). [Edizioni del Sud].

¹⁴⁸ Sawicka, I. (2015). A crossroad between West, East and Orient: The case of Albanian culture. *Colloquia Humanistica*, 6, Article 006. <https://doi.org/10.11649/ch.2013.006>

¹⁴⁹ Ministero Degli Affari Esteri Commissione per La Pubblicazione dei Documenti Diplomatici. (1968). *Documenti diplomatici italiani* (Serie II, Vol. XXI, Document no. 58). Istituto Poligrafico e Zecca Dello Stato Libreria dello Stato. Crispi drejtuar Blanc, gusht 18, 1887, p. 43. Për më shumë mbi vizitën e Crispit tek Bismarku shih: Duggan, C. (2000). *Creare la nazione - Vita di Francesco Crispi* (pp. 601-605). Laterza. Chapter XIV: Preparativi di guerra (1887-1888) - La visita a Bismarck.

¹⁵⁰ Qesari, E. (2017). Le orme dell'egemonia italiana sul protonazionalismo albanese e lo scontro con l'alleato asburgico sull'istruzione scolastica. In F. Altamura (Ed.), *Puglia e Grande Guerra: Tra dimensione adriatica e fronte interno: Fonti e ricerche* (pp. 17-31). [Edizioni del Sud].

¹⁵¹ Për më tepër mbi çështjen e sekularizimit të sistemit arsimor italian shih: Isastia, A. M., & Visani, A. (2008). *L'idea laica tra Chiesa e massoneria: La questione della scuola* (pp. 82-90). Atanòr.

Në fillim të shekullit XX, rrjeti i shkollave italiane shtrihej deri në Prevezë. Kjo natyrshëm nuk shihej me sy të mirë nga Austria, e cila nuk hezitoi të ndërmarrë hapa për të ruajtur pozitën e saj mbizotëruese tek popullata katolike. Austria e bëri gjuhën shqipe gjuhë zyrtare në të gjitha shkollat e financuara prej saj, duke hequr gjuhën italiane, dhe e sulmoi politikën italiane duke theksuar puritetin religjioz dhe masonizmin e kryeministrit të atëhershëm italian, Crispit. Megjithatë, përpjekjet e Austrisë nuk sollën rezultatet e pritura, dhe hovi i përhapjes së shkollave italiane vijoi me ritme të qëndrueshme, edhe për faktin se ato nuk aplikonin tarifa regjistrimi dhe ofronin libra pa pagesë. Pavarësisht se, sipas Skëndit¹⁵², austriakët ishin të sigurtë në qëllimin e tyre për formimin e një ndërgjegjeje kombëtare shqiptare, ndërkohë që Italia ishte kryesisht e interesuar në përhapjen e gjuhës italiane në funksion të interesave të saj, madje dhe mësimi i shqipes, siç deklaroi edhe vetë Visconti Venosta më 1903, ishte një kamuflim për të shmangur dyshimet mbi qëllimet e Italisë dhe për të fituar simpatinë e popullsisë vendase¹⁵³. Megjithatë, italianët gëzonin një avantazh të dukshëm ndaj austriakëve, për shkak të natyrës gjithëpërfshirëse të shkollave italiane, ku pranoheshin edhe nxënës të besimeve të tjera fetare, përveç atij katolik. Duke qenë më të aksesueshme dhe me një shtrirje që mbulonte një territor nga Shkodra deri në Korfuz, ato ishin jashtëzakonisht efikase për përhapjen e kulturës italiane tek të gjitha shtresat e popullsisë.

Programi i Ismail Qemalit për Arsimin sipas dokumenteve të Arkivit Diplomatik italian

Tendenca e Italisë për kolonizimin e Shqipërisë shërbeu si shtysë për Ismail Qemalin t'u paraqiste italianëve programin e tij për shtetin shqiptar, ku Italia supozohej të luante një rol kyç. Ismail Qemali, si një diplomat i mprehtë dhe i pajisur me një zgjuarsi politike të spikatur, nuhati interesat e pushpallura të Fuqive të Mëdha dhe u përpoq të manovronte në varësi të dinamikave të arenës ndërkombëtare për të ndërtuar aleanca strategjike në dobi të kauzës shqiptare. Sipas arkivave diplomatike italiane, më 17 gusht 1908, ai takon ambasadorin italian në Londër, Sangiuliano, i cili më vonë do të rimarrë postin e ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë më 31 mars 1910. Pas këtij takimi, ambasadori Sangiuliano raportoi tek ministri i linjës se, gjatë bisedës, Ismail Qemali kishte parashtruar pikat kryesore të programit të tij dhe e këshilloi ministrin: "Cilido qoftë niveli i besimit që ai meriton, programi që më parashtroni ia vlen të merret në konsideratë. Qoftë edhe me ndonjë sakrificë financiare, ne mund të lehtësojmë zbatimin e pjesëshëm të tij dhe të arrijmë një rezultat politik të çmueshëm".¹⁵⁴

Po ku konsistonte sakrificat financiare që i kërkohej Italisë nga ana e Ismail Qemalit? Bashkimin e shqiptarëve si komb dhe afirmimin e identitetit të tyre kombëtar, Ismail Qemali e shihte të lidhur ngushtë me përparimin e tyre arsimor dhe kulturor. Kërkesa për subvencione kishte të bënte pikërisht me hapjen e shkollave shqiptare, shtypjen dhe shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe, si dhe me nxitjen e edukimit dhe formësimit të ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Kjo, sipas Qemalit, ishte një strategji për shëndoshjen dhe forcimin e identitetit kombëtar, që do të ndihmonte në ruajtjen e unitetit kombëtar dhe në përballimin e presioneve të huaja. Nga ana tjetër, forcimi i kombit shqiptar kishte edhe përfitime të drejtpërdrejta për interesat italiane, siç konfirmon vet Sangiuliano në raportin e tij: "Në fakt,

¹⁵² Skëndi, S. (2000). Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912. Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.

¹⁵³ Qesari, E. (2017). Le orme dell'egemonia italiana sul protonazionalismo albanese e lo scontro con l'alleato asburgico sull'istruzione scolastica. In F. Altamura (Ed.), *Puglia e Grande Guerra: Tra dimensione adriatica e fronte interno: Fonti e ricerche* (pp. 17-31). [Edizioni del Sud].

¹⁵⁴ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891-1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). Dokumente Diplomatike Italiane Mbi Ismail Qemalin (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

na leverdis gjithçka që mund të kontribuojë në formimin e një kombi shqiptar të ndërgjegjshëm, të fortë dhe të aftë për t'u bërë një barrikadë ndaj ambicieve të palëve të tjera; si dhe gjithçka që mund të zhvillojë resurset ekonomike të këtij rajoni dhe do të na lejojë të marrim pjesë në ngritjen e vlerës së tij."¹⁵⁵

Sipas Sangiuliano, ndonëse vështirësitë për realizimin e këtij projekti ishin të mëdha, optimizmi i Ismail Qemalit për të arritur rezultate të prekshme ishte i dukshëm. Ai parashikonte se, nëse Italisë do t'i jepeshin mundësitë e duhura dhe do të shfrytëzoheshin mundësitë e periudhës së tanishme të liberalizmit dhe bashkëpunimit mes kombësive dhe besimeve të ndryshme, mund të arriheshin disa rezultate ekonomike dhe politike të rëndësishme. Megjithatë, ai paralajmëronte se kjo periudhë mund të mos të zgjaste shumë dhe se duhej vepruar shpejt për të siguruar avantazhe të qëndrueshme për të dyja palët.¹⁵⁶ Ismail Qemali ishte i bindur se Kushtetuta osmane, e hartuar përpara luftës turko-ruse, nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha ndjenjat dhe nevojat e kombeve të Perandorisë. Nevojitej që, duke ruajtur integritetin territorial, kombet brenda Perandorisë të gëzonin një autonomi të gjerë administrative. Ai nuk përjashtonte mundësinë e ndarjes së Shqipërisë në një, dy, tri apo katër vilajete, por, siç theksonte ai, me kushtin e panegociueshëm, që në to, të përfshiheshin të gjitha rajonet gjeografikisht dhe etnikisht shqiptare. Kjo do të përfshinte edhe zonat e vilajeteve të Kosovës dhe Manastirit, të cilat, siç këmbëngulte Ismail Qemali, nuk duhej të shpërndaheshin për t'u aneksuar nga ndonjë komb tjetër. Ismail Qemali ushqente besimin se, nëse Italia do të bashkëpunonte në këtë drejtim, kjo do t'i sillte përfitime të dukshme për interesat e saj. Kjo jo vetëm për sa i përket rritjes së ndikimit të Italisë në Shqipëri, por edhe për krijimin e një mburoje të fortë etnike që do të mbronte Shqipërinë nga ambiciet territoriale të shteteve të tjera. Ismail Qemali arrin të bindë Sangiulianon se hapja sa më parë e një numri të madh shkollash shqipe, si dhe shtypja dhe shpërndaja e librave shqip, ishin hapat e parë efikas për zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Ai argumentonte se, me t'u realizuar e drejta për arsimimin në gjuhën shqipe, askush nuk do të mund ta revokonte më këtë të drejtë, as vetë Abdul Hamidi, nëse do të rimerrte pushtetin absolut që kishte më parë.¹⁵⁷

Për mbulimin e shpenzimeve të shtypjes dhe shpërndarjes së librave në gjuhën shqipe, si dhe për hapjen e shkollave, Ismail Qemali kishte përllogaritur se nevojitej një shumë prej rreth 150 mijë lirash italiane, të cilat Italia duhej t'i jepte fshehtëazi, pa ngjallur dyshime, dhe menjëherë. Ishte e rëndësishme që të mos humbej kohë. Më tej, kjo shumë, sipas planifikimeve të Ismail Qemalit, do të mund të kompensohej nga realizimi i pjesës së tretë të programit të tij: "Penetrimi ekonomik italian në Shqipëri".¹⁵⁸

Ismail Qemali premonte se nëse kapitalistët italianë do të shpejtonin, tani që ai dhe miqtë e tij ishin në pushtet në Kostandinopojë dhe në Shqipërinë toske, iniciativat italiane nuk do të përballeshin me pengesa që kishin hasur në të shkuarën, por do të kishin të gjitha lehtësitë. Do të mund të kishin përparësi në shfrytëzimin e minierave, pyjeve, ndërtimin e rrugëve, në industri etj. Me një pjesë të

¹⁵⁵ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891–1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). DOKUMENTE DIPLOMATIKE ITALIANE MBI ISMAIL QEMALIN (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

¹⁵⁶ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891–1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). Dokumente Diplomatike Italiane Mbi Ismail Qemalin (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

¹⁵⁷ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891–1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). DOKUMENTE DIPLOMATIKE ITALIANE MBI ISMAIL QEMALIN (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

¹⁵⁸ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891–1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). Dokumente Diplomatike Italiane Mbi Ismail Qemalin (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

fitimeve që do të nxirreshin prej sipërmarrjeve do të mund të subvencionohej mësimi i gjuhës shqipe, që për momentin, Ismail Qemali këshillonte të subvencionohej në mënyrë të fshehtë nga qeveria italiane nëpërmjet Shoqatës "Dante Alighieri", apo ndonjë Instituti financiar italian pranë Qeverisë dhe Mbretit. Ndër sipërmarrjet e ndryshme, ajo që Ismaili rekomandonte së tepërmi, ishte ndërtimi i hekurudhës Vlorë-Manastir.

Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë, theksonte Ismail Qemali, do të favorizonte krijimin e një mënyre jetese më të qytetëruar dhe më të rregullt. Edhe shqiptarët më të trazuar, gegët, do ta vlerësonin rendin dhe ligjshmërinë kur të kuptonin se ato ishin kushtet thelbësore për të siguruar mirëqenie ekonomike, në një kohë kur anarkia dhe dhuna ishin mjete të domosdoshme për jetesë në shumicën e rajoneve gege.¹⁵⁹ Sangiuliano i përcjell programin e Ismail Qemalit eprorit të tij, Tittoni-t, por jo pa bërë vëzhgimet përkatëse, të cilat, në linja të përgjithshme, përkohë edhe me vëzhgimet e ambasadorit italian në Kostandinopojë, Imperiali. Pavarësisht rezervave mbi mundësitë e realizimit të pjesës së organizimit territorial dhe penetrimit ekonomik, të dy ambasadorët dakordësonin për dhënien e subvencioneve për hapjen e shkollave shqipe, me kushtin e vetëm që, përveç shqipes, të studiohej gjithashtu edhe gjuha dhe kultura italiane. Sangiuliano e mendonte hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, ashtu siç e kërkonte programi i Ismail Qemalit, si një hap me rëndësi të madhe për të ardhmen e kombit shqiptar, por edhe si një veprim që do të shërbente për interesat e Italisë. Ai ishte i informuar për gjendjen e vështirë dhe për mungesat e theksuara në arsimin shqiptar, sidomos për mungesën e mësuesve të kualifikuar, çka do të krijonte vështirësi të konsiderueshme. Sidoqoftë, Sangiuliano vlerësonte si thelbësore që qeveritarët e ardhshëm të Turqisë, qofshin ata edhe despotë, të përballëshin me faktin e kryer: e drejta e njohur dhe e zbatuar e mësimi dhe shtypjes së librave në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, ai besonte se koncepti i Abdul Hamidit, i cili përpiqej të ruante unitetin e Islamit duke penguar lindjen e ndërgjegjes kombëtare ndër shqiptarët, nuk do të kishte më vend në mesin e këtij populli.

Konkluzione

Në fillim të shekullit XX, politika italiane ndaj Shqipërisë ishte shpesh e karakterizuar nga tendenca kolonialiste, të cilat përputheshin me dinamikën e raporteve të Italisë me Austro-Hungarinë dhe me ndryshimet në ekuilibrat gjeopolitikë. Në këtë kontekst, politikat italiane në Shqipëri, shërbenin për të zgjeruar influencën dhe për të fituar simpatinë e popullsisë vendase. Relacionet e përgatitura për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, lidhur me gjendjen e arsimit në Shqipëri para Luftës së Parë Botërore, tregojnë se arsimi ishte në një gjendje primitive, sidomos në zonat rurale, ku analfabetizmi arrinte nivele ekstreme. Gjendja ishte pak më e përmirësuar në qytetin e Shkodrës, kryesisht për shkak të ndikimit të klerit austriak dhe shkollave të ngritura nga Italia, të cilat synonin balancimin e influencës austriake. Qytetet më të orientuara ndaj arsimit ishin Korça, Gjirokastra dhe Shkoder.

Në pjesën myslimane të Shqipërisë, shkolla ishte e lidhur ngushtë me xhaminë, dhe për të shkruar përdorej alfabeti turko-arab. Në këto shkolla, të rinjtë mësonin kryesisht rreth Kuranit dhe kulturës islame, ndërsa nuk përmendej aspak kultura apo historia shqiptare. Ndërsa në shkollat greke, të cilat

¹⁵⁹ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Serie Politica P (1891–1916), Albania Pacco 676*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë]; Çiraku, E. (2024). Dokumente Diplomatike Italiane Mbi Ismail Qemalin (17 gusht 1908-21 korrik 1910). *Studime Historike Historical Studies*, 2. <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>

ishin thuajse tërësisht në funksion të propagandës helenizuese, nuk mësohej fare gjuha shqipe, e cila konsiderohej nga grekët dhe fqinjët sllavë si një gjuhë barbare.¹⁶⁰

Gjatë periudhës së Luftës së parë Botërore, për vitin shkollor 1916-1917, Italia në kuadër kryesisht të interesave të saj, hapi në territoret e okupuara shqiptare 110 shkolla. Në këtë panoramë, gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, për vitin shkollor 1916-1917, Italia, për qëllime kryesisht të interesave të saj strategjike, hapi në territoret e okupuara shqiptare 110 shkolla. Në vitin 1918, numri i shkollave italiane arriti 155, me 278 mësues dhe 10,000 nxënës. Dokumentet arkivore italiane konfirmojnë se, edhe në zonat e okupuara nga francezët dhe austriakët, shkollat italiane nuk ishin më të pakta. Mësuesit italianë, në shumicën e rasteve, ishin ushtarë të mobilizuar që nuk ishin të aftë për luftë, ose rezervistë të moshës më të madhe, të cilët kishin kaluar një trajnim të shpejtë në lëndë si historia, gjeografia dhe zakonet lokale shqiptare. Parapëlqejesh që ata që do të emëroheshin në këto shkolla të ishin persona me origjinë shqiptare (arbëreshë), të cilët dinin shqip. Një fokus i veçantë i këtyre shkollave ishte mësimi i gjuhës shqipe dhe italiane, si dhe i disa lëndëve elementare. Po ashtu, edhe në vitet në vijim, Italia vazhdoi të investojë në zhvillimin e arsimit në Shqipëri, gjithmonë në funksion të interesave të saj strategjike. Nga ana tjetër, një numër i madh studentësh shqiptarë ndjekin mësimet në universitetet italiane. Sipas Nathanaili (2016: 56), në vitin 1921, nga 358 të rinj shqiptarë që ndjekin studimet e larta jashtë vendit, 116 gjenden në Itali.

Referenca

- Arkivi i Institutit të Historisë. (1891–1918). *Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri, Roma* (Fondi: Sottosegretariato Affari Albanesi, Pacco 136-9; Serie Politica P.676). Tiranë: Arkivi digjital i Institutit të Historisë.
- Botime dokumentesh
- Ministero degli Affari Esteri, Commissione per la Pubblicazione dei Documenti Diplomatici. (1968). *Documenti Diplomatici Italiani*, Serie II, Vol. XXI. Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, Libreria dello Stato.
- Ministero degli Affari Esteri, Commissione per la Pubblicazione dei Documenti Diplomatici. (1979). *Documenti Diplomatici Italiani*, Serie II, Vol. V. Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, Libreria dello Stato.
- Artikuj të botuar në revista shkencore
- Çiraku, E. (2024). Dokumente diplomatike italiane mbi Ismail Qemalin (17 gusht 1908 – 21 korrik 1910). *Studime Historike*, (2). <https://doi.org/10.61773/mq2j3d64>
- Qesari, E. (2017). Le orme dell'egemonia italiana sul protonazionalismo albanese e lo scontro con l'alleato asburgico sull'istruzione scolastica. Në F. Altamura (Red.), *Puglia e Grande Guerra: Tra dimensione adriatica e fronte interno – fonti e ricerche* (fq. 17–31).
- Sawicka, I. (2015). A crossroad between West, East and Orient: The case of Albanian culture. *Colloquia Humanistica*, 6. <https://doi.org/10.11649/ch.2013.006>
- Botime historiografike
- Baldacci, A. (1929). *L'Albania*. Roma: L'Istituto per l'Europa Orientale.
- Çeku, E. (2024). *Shqiptarët dhe Shqipëria 1908–1912*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Duggan, C. (2000). *Creare la nazione: Vita di Francesco Crispi* (Kap. XIV: Preparativi di guerra [1887–1888] – La visita a Bismarck). Roma–Bari: Laterza.
- Hobsbawm, E. J. (1996). *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1970-a*. Tiranë: Toena.
- Isastia, A. M., & Visani, A. (2008). *L'idea laica tra Chiesa e Massoneria: La questione della scuola*. Roma: Atanòr.
- Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqip: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912–1944*. Tiranë: UET Press.
- Skëndi, S. (2000). *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878–1912*. Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.

¹⁶⁰ Archivio del Ministero degli Affari Esteri (AMAE). *Sottosegretariato Affari Albanesi, Pacco 136-9*. [Arkivi Digjital i Institutit të Historisë, Tiranë].